



AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
REGULATORNI AUTORITET ZA ELEKTRONSKE I POŠTANSKE KOMUNIKACIJE
REGULATORY AUTHORITY OF ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS

Nr. Prot. 043/B/13

Klasa: 01/13

Nr. i Regjistrimit: 020

Miratuar me Vendimin Nr.424 të Bordit të ARKEP (Ref. Nr.Prot.042/B/13)

RREGULLORE

PËR

KUALITETIN E SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

KAPITULLI I

Baza Ligjore, Qëllimi dhe Fushëveprimi, Përkufizimet

Neni 1

Baza Ligjore

- 1.1 Kjo rregullore është nxjerr në bazë të nenit 10, pika (4) dhe (7), neni 28, pika (2), (5) dhe pika (6); neni 65 pika (1), neni 69, pika (1) dhe pika (2) të Ligjit Për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje i njohur si - Ligji*); Dokumentet ETSI EG 202 057, ETSI EG 201 769 të Institutit Evropian për Standardet Telekomunikuese (ETSI); Rekomandimet E.800, P.862, Y.1540 dhe Y.1541 të Unionit ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU-T); Direktivën 2002/22/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian të datës 7 Marsit 2002 mbi Shërbimet Universale; Direktivën 2009/136/EC (*Aneksi III*) të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian të datës 25 Nëntor 2009.

Neni 2

Qëllimi dhe fushëveprimi i kësaj Rregulloreje

- 2.1 Kjo rregullore përcakton; parametrat e kualitetit për shërbimet e komunikimeve elektronike të ofruara nga operatorët në tregun e shitjeve me pakicë, rregullat për vlerat e deklaruara të parametrave të kualitetit së shërbimit, raportet e dorëzuara dhe publikuara, kërkesat për matjet e parametrave dhe raportin vjetor të kualitetit të publikuar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - ARKEP*).

Faqe 1 nga 40

Neni 3 Përkufizimet

- 3.1 Kuptimi ose definicioni i cilësdo fjalë, frazë apo shprehje sipas ligjit gjithashtu do të jetë i zbatueshëm për atë fjalë, frazë apo shprehje në këtë rregullore.
- 3.2 Termat dhe shprehjet që pasojnë do të kenë këtë kuptim:

Kualiteti e Shërbimit (QoS) - Tërësia e efekteve të performancës së shërbimit që përcakton nivelin e kënaqshmërisë së një përdoruesi të shërbimit dhe tërësinë e karakteristikave të shërbimit të telekomunikacionit që kanë aftësinë për t'i përmbushur nevojat e deklaruara dhe të nënkuptuara të përdoruesit të shërbimit.

Shërbimi i mesazheve të shkurtra (Short Message Service - SMS) - shërbim i komunikimeve elektronike që përfshin transportin e një mesazhi të shkurtër alfanumerik (≤ 160 karaktere alfanumerike) nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit mobil të tillë që çdo përdorues mund të përdorë pajisje të lidhur në një pikë fundore të rrjetit për të shkëmbyer këto mesazhe me një përdorues tjetër të pajisjes së lidhur me një pikë fundore të rrjetit.

Raporti i thirrjeve të pasuksesshme/dështuara - Raporti në mes të thirrjeve të dështuara me numrin total të tentativave të thirrjeve brenda një periudhe të caktuar kohore. Thirrje e dështuar është një tentativë-thirrje drejt një numri valid, e realizuar duke pasuar tonin e numër-formimit, si rezultat i së cilës origjinuesi i thirrjes nuk dëgjon as tonin e zënë nga ana e thirrur, as tonin e ziles, as sinjalin e përgjigjes, brenda 30 sekondave nga momenti i zgjedhjes së shifrës së fundit të numrit të thirrur. Thirrja e ndërprerë/shkëputje gjatë intervalit kohor të matjes do të definohet po ashtu si thirrje e pasuksesshme. Periudha kohore e matjes nënkupton periudhën kohore kur do të matet kualiteti e transmetimit të bisedës.

Koha e vendosjes së thirrjes - është periudha kohore që fillon nga momenti kur informacioni i adresës së kërkuar për vendosjen e thirrjes është pranuar nga rrjeti ndërsa mbaron në momentin kur pala e thirrëse pranon tonin e zënë, ose tonin e ziles, ose sinjalin e përgjigjes nga ana e palës së thirrur. Në rastet kur përdoret sinjalizimi i mbivendosur (overlap) matja fillon nga momenti kur është marrë informacioni i mjaftueshëm për adresën që lejon rrjetin të fillojë rrugëtimin e thirrjes.

Raporti i SMS të Dërguar Pa Sukses - është raporti në mes të SMS-ve, të cilët janë dërguar, por nuk janë pranuar, ndaj numrit të përgjithshëm të SMS të dërguar brenda një periudhe të caktuar kohore. Një SMS do të cilësohet si i pasuksesshëm në qoftë se nuk pranohet brenda 300 sekondave.

Koha e dërgimit të SMS - përkufizohet si kohëzgjatja në sekonda, nga momenti kur SMS është dërguar deri në kohën kur SMS është pranuar.

Kualiteti i transmetimit të zërit – përkufizohet si një vlerë kuantitative e matur duke përdorur algoritmin për Vlerësimin e Perceptimit të Kualitetit të Zërit (PESQ) në përputhje me Rekomandimin ITU-T P.862.

Koha e pranimit të përgjigjes në shërbimin e direktoriumit publik (numërorët) dhe shërbimin e operatorit - përkufizohet si kohëzgjatja në sekonda nga momenti kur shifra e fundit e direktoriumit publik (numërorit) ose shërbimit të operatorit është zgjedhur deri në momentin kur stafi i operatorit përgjigjet.

Shërbimi i Operatorit (Help Desk) - përkufizohet si shërbim telefonik ku klientët paraqesin defektet në shërbimet e ofruara nga operatori.

Shërbimi i kërkimit të informatave në numërorin telefonik - përkufizohet si shërbim për sigurimin e informatave në numërorin telefonik, duke përdorur shërbime të komunikimeve elektronike. Ky shërbim publikisht ofron informacion në lidhje me përdoruesit, të cilët kanë dhënë pëlqimin e tyre që të dhënat e tyre të jenë të përfshira në numërorin telefonik të përdoruesve për qasje publike, gjithmonë duke marrë parasysh kufizimet e specifikuar nga ana e përdoruesit.

Shpejtësia minimale (Shpejtësia e garantuar) – është shpejtësia mëe ulët, të cilën e ofron ofruesi i qasjes në internet për përdoruesin fundorë në përputhje me kontratën.

Formatted: Font: Not Bold

Shpejtësia maksimale (Shpejtësia e reklamuar) – është shpejtësia që një ofrues i shërbimit të qasjes në internet e përdor në komunikimet komerciale, përfshirë reklamimet dhe marketingun lidhur me promovimin e ofertave të qasjes në internet. Në rast se shpejtësitë janë të përfshira në një ofertë marketingu të ofruesit të qasjes në internet, shpejtësia e reklamuar duhet të specifikohet në informacionin e publikuar dhe në kontratë për secilën ofertë.

Formatted: Font: Not Bold

Shpejtësia e zakonshme në dispozicion: është shpejtësia ku një përdorues mund të arrij shumicën e kohës gjatë qasjes në shërbime.

Formatted: Font: Not Bold

Shpejtësia e bartjes së të dhënave (Data transmission rate) është shpejtësia (në kbps) që është arritur veçmas për ngarkim (upload) dhe shkarkim (download) të të dhënave. Kompjuteri i shfrytëzuesit duhet të përjashtohet nga testi, që do të thotë se testi realizohet deri te pika terminuese e rrjetit (Network Terminal Point – NTP).

Vonesa (latenca) është gjysma e kohës në mili sekonda që nevojitet për ICPM Kërkesë/Përgjigje e përsëritur (Ping) në adresë të vlefshme të IP-së. (ETSI EG 202 057-04 pika 5.5).

Variacioni i vonesës (Jitter) është koha në mili sekonda që tregon variacionin e vonesës ndërmjet paketave të dërguara dhe të pranuar (siç është definuar në Rekomandimin e ITU-T Y.1540 pika 6.2.4 dhe e shpjeguar në mënyrë më të detajuar në Rekomandimin e ITU-T, Y.1541 Aneksi II).

Shkalla e Humbjes se Paketës (Packet Loss Ratio) është shkalla e humbjes së paketës IP që rezulton nga transmetimi i të gjitha paketave IP në një zonë të caktuar (Rekomandimi ITU-T Y.1540 pika 6.4).

Shkalla e gabimit të paketës (Packet Error Ratio) është shkalla e gabimit të pakos IP që rezulton në totalin e pakos së suksesshme IP plus gabimi i pakos IP që rezulton në një zonë të caktuar (Rekomandimi ITU-T Y. 1540 pika 6.3).

Dispozicioni i Shërbimit (Service Availability/shfrytëzuesit fundor mund të shfrytëzojnë shërbimin) është mesatarja aritmetikore nga numri total i shërbimit në dispozicioni i rezultateve të llogaritura gjatë një cikli të pagesës. Dispozicioni i shërbimit gjatë ciklit të pagesës është përcaktuar me formulën në vijim:

$$p = \frac{T}{t_k \cdot n} \cdot 100\%$$

ku p – Dispozicioni i Shërbimit si përqindje; T – Koha totale e shërbimit në dispozicion në orë;
 t_k – koha e matjes në orë; n – numri total i pikave të rrjetit fundor.

KAPITULLI II Shërbimet e Telefonisë së zërit dhe SMS

Neni 4 Shërbimet që do të Kontrollohen

- 4.1 Shërbimi telefonik në dispozicion për publikun në rrjetet publike të komunikimit fiks.
- 4.2 Shërbimi telefonik në dispozicion për publikun në rrjetet publike të komunikimit mobil.
- 4.3 SMS në rrjetin publik të komunikimit mobil.
- 4.4 Shërbimi telefonik në dispozicion për publikun duke përdorur interkoneksionin.
- 4.5 SMS duke përdorur interkoneksionin.
- 4.6 Shërbimet telefonike në dispozicion për publikun në shërbimet shoqëruese të rrjeteve publike të komunikimit fiks si në shërbimin e direktoriumit publik (numërorët) dhe shërbimet e operatorit.

Neni 5 Kualiteti i Shërbimit (QoS) - Parametrat që do të maten

- 5.1 Çështjet e përgjithshme:

- 5.1.1 ARKEP përcakton parametrat e kualitetit për të gjitha shërbimet që do të kontrollohen.
- 5.1.2 ARKEP përcakton vlerat e parametrave të kualitetit të përfshira në obligimet për shërbimet universale.
- 5.1.3 Operatorët vendosin vlerat e parametrave të kualitetit, të cilat nuk janë të përfshira në obligimet për shërbimet universale, dhe pastaj bëjnë deklarinimin e këtyre vlerave sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje.

5.2 Lista e parametrave që do të maten:

- 5.2.1 Lista e parametrave për shërbimin telefonik në dispozicion për publikun në rrjetin publik të komunikimit fiks

Parametrat e Kualitetit të Shërbimit	
1. Koha e ofrimit me linjë të rrjetit fiks për përdoruesin fundor (<i>Realizimi i Qasjes</i>)	1.1 Numri minimal i ditëve kalendarike, të llogaritura nga momenti i dorëzimit të kërkesës tek operatori e deri në momentin e instalimit të linjës, për 95% e përdorueseve.
	1.2 Numri minimal i ditëve kalendarike, të llogaritura nga momenti i dorëzimit të kërkesës tek operatori e deri në momentin e instalimit të linjës, për 99% e përdorueseve.
	1.3 Përqindja e linjave të përdoruesve, të cilat janë instaluar brenda 10 ditëve kalendarike, në raport me të gjitha linjat e instaluara.
	1.4 Përqindja e linjave të përdoruesve në raport me numrin e përgjithshëm të linjave, të cilat janë të instaluar brenda afatit kohor që palët janë pajtuar.
2. Numri i defekteve	2.1 Numri i defekteve për një linjë të përdoruesit fundor
3. Kohëzgjatja për riparimin e defekteve	3.1 Koha minimale (e shprehur në orë) e llogaritur prej momentit të raportimit të defektit nga përdoruesit deri në momentin kur 80% e defekteve të linjave të përdoruesve janë riparuar.
	3.2 Koha minimale (e shprehur në orë) e llogaritur prej momentit të raportimit të defektit nga përdoruesit deri në momentin kur 80% të defekteve në pajisjet e operatorit, përveç linjës së përdoruesit janë riparuar;

Parametrat e Kualitetit të Shërbimit	
	3.3 Koha minimale (e shprehur në orë) e llogaritur prej momentit të raportimit të defektit nga përdoruesit deri në momentin kur 95% e defekteve në linjën e përdoruesit janë riparuar.
	3.4 Koha minimale (e shprehur në orë) e llogaritur prej momentit të raportimit të defektit nga përdoruesit deri në momentin kur 95% të defekteve në pajisjen e operatorit, përveç linjës së përdoruesit janë riparuar;
	3.5 Numri i defekteve, të shprehura në përqindje, në raport me numrin total të defekteve të raportuara nga përdoruesit, të cilat janë riparuar në afatin kohor prej tri (3) ditëve kalendarike.
	3.6 Numri i defekteve, të shprehura në përqindje, në raport me numrin total të defekteve të raportuara nga përdoruesit, të cilat janë riparuar në afatin kohor për të cilin palët kanë rënë dakord.
4. Raporti i thirrjeve të dështuara	4.1 Raporti në përqindje i thirrjeve të dështuara për thirrjet kombëtare
5. Koha e vendosjes së thirrjes	5.1 Vlera mesatare kohore e shprehur në sekonda për thirrjet kombëtare
	5.2 Intervali kohor në sekonda brenda se cilës vendosen 95% e thirrjeve më të shpejta kombëtare
6. Kualiteti e transmetimit të zërit	6.1 Shkalla mesatare e transmetimit të kualitetit të zërit, e cila matet duke përdorur algoritmin PESQ
7. Saktësia e faturave	7.1 Përqindja e faturave të ankimuara nga përdoruesit në raport me numrin total të faturave të dërguara tek përdoruesit.

5.2.2 Lista e parametrave për shërbimin telefonik në dispozicion për publikun në rrjetin publik të komunikimit mobil

Parametrat e Kualitetit të Shërbimit	
1. Raporti i thirrjeve të dështuara	1.1 Raporti në përqindje i thirrjeve të dështuara për thirrjet kombëtare
2. Koha e vendosjes së thirrjes	2.1 Vlera mesatare kohore e shprehur në sekonda për thirrjet kombëtare

Parametrat e Kualitetit së Shërbimit	
	2.2 Intervali kohor në sekonda brenda se cilës vendosen 95% e thirrjeve më të shpejta kombëtare
3. Kualiteti e transmetimit të zërit	3.1 Shkalla mesatare e transmetimit të kualitetit së zërit, e cila matet duke përdorur algoritmin PESQ
4. Saktësia e faturave	4.1 Përqindja e faturave te ankimuara nga përdoruesit në raport me numrin total të faturave të dërguara tek përdoruesit.

5.2.3 Lista e parametrave për SMS në rrjetin publik të komunikimit mobil

Parametrat e Kualitetit së Shërbimit	
1. Kualiteti i dërgimit të SMS	1.1 Përqindja e pasuksesshme e SMS të dërguara
	1.2 Vlera mesatare e kohës së dërgimit të SMS

5.2.4 Lista e parametrave për shërbimin telefonik në dispozicion për publikun duke përdorur interkoneksionin.

Parametrat e Kualitetit së Shërbimit	
1. Raporti i thirrjeve të dështuara	1.1 Raporti në përqindje i thirrjeve të dështuara për thirrjet kombëtare
2. Koha e vendosjes së thirrjes	2.1 Vlera mesatare kohore e shprehur në sekonda për thirrjet kombëtare
3. Kualiteti e transmetimit të zërit	3.1 Shkalla mesatare e transmetimit të kualitetit së zërit e cila matet duke përdorur algoritmin PESQ

5.2.5 Lista e parametrave për SMS duke përdorur interkoneksionin

Parametrat e Kualitetit së Shërbimit	
1. Kualiteti i dërgimit të SMS	1.1 Përqindja e pasuksesshme e SMS të dërguara
	1.2 Vlera mesatare e kohës së dërgimit të SMS

5.2.6 Lista e parametrave të kualitetit dhe vlerat e parametrave që do të përfshihen në obligimet e shërbimeve universale.

Parametrat e Kualitetit së Shërbimit		Vlerat e parametrave
1. Numri i defekteve	1.1 Numri i defekteve që kane te bëjnë me një linjë të përdoruesit	<i>Këto vlera të parametrave do të specifikohen pas miratimit të rregullores mbi Shërbimet Universale nga ana e ARKEP</i>
2. Kohëzgjatja për riparimin e defekteve	2.1 Numri i defekteve të shprehura, në përqindje, në raport me numrin total të defekteve të raportuara nga përdoruesit, të cilat janë riparuar në afatin kohor prej tri (3) ditëve kalendarike.	<i>Këto vlera të parametrave do të specifikohen pas miratimit të rregullores mbi Shërbimet Universale nga ana e ARKEP</i>
	2.2 Numri i defekteve, të shprehura në përqindje, në raport me numrin total të defekteve të raportuara nga përdoruesit, të cilat janë riparuar në afatin kohor, për të cilin palët kanë rënë dakord.	<i>Këto vlera të parametrave do të specifikohen pas miratimit të rregullores mbi Shërbimet Universale nga ana e ARKEP</i>
3. Raporti i thirrjeve të dështuara	3.1 Raporti në përqindje i thirrjeve të dështuara për thirrjet kombëtare	<i>Këto vlera të parametrave do të specifikohen pas miratimit të rregullores mbi Shërbimet Universale nga ana e ARKEP</i>
4. Koha e vendosjes së thirrjes	4.1 Vlera mesatare kohore e shprehur në sekonda për thirrjet kombëtare	<i>Këto vlera të parametrave do të specifikohen pas miratimit të rregullores mbi Shërbimet Universale nga ana e ARKEP</i>
	4.2 Intervali kohor në sekonda brenda se cilës vendosen 95% e thirrjeve më të shpejta kombëtare	<i>Këto vlera të parametrave do të specifikohen pas miratimit të rregullores mbi Shërbimet Universale nga ana e ARKEP</i>
5. Saktësia e faturave	5.1 Përqindja e faturave të ankimuara nga përdoruesit në raport me numrin total të faturave të dërguara tek përdoruesit.	<i>Këto vlera të parametrave do të specifikohen pas miratimit të rregullores mbi Shërbimet Universale nga ana e ARKEP</i>
6. Intervali kohor për përgjigje në shërbimin e direktoriumit publik (numërorit)	6.1 Mesatarja kohore, në sekonda, e përgjigjes	<i>Këto vlera të parametrave do të specifikohen pas miratimit të rregullores mbi Shërbimet Universale nga ana e ARKEP</i>
	6.2 Numri i thirrjeve të përgjigjura brenda 20 sekondave	<i>Këto vlera të parametrave do të specifikohen pas miratimit të rregullores mbi Shërbimet</i>

Parametrat e Kualitetit së Shërbimit		Vlerat e parametrave
		<i>Universale nga ana e ARKEP</i>
7. Intervali kohor për përgjigje në shërbimin e operatorit	7.1 Mesatarja kohore, në sekonda, e përgjigjes	<i>Këto vlera të parametrave do të specifikohen pas miratimit të rregullores mbi Shërbimet Universale nga ana e ARKEP</i>
	7.2 Numri i thirrjeve të përgjigjur brenda 20 sekondave	<i>Këto vlera të parametrave do të specifikohen pas miratimit të rregullores mbi Shërbimet Universale nga ana e ARKEP</i>

5.3 Kërkesa shtesë për Ofruesin e Shërbimeve Universale;

5.3.1 çdo parametër, i cili nuk është përfshirë në 5.2.6, duhet të deklarohet nga ofruesi i shërbimit universal sipas kërkesave të listuara në paragrafin 5.2.1.

Neni 6

Deklaratat e Kualitetit të Shërbimit

- 6.1 Operatorët janë të detyruar që jo më vonë se data 1 Shkurt të çdo viti, të dorëzojnë në ARKEP deklaratat e kualitetit për vitin aktual për shërbimet e ofruara sipas formularit të deklaratës së përfshirë në Anekset 1 deri 5 të kësaj rregulloreje.
- 6.2 Nëse operatori fillon të ofroje shërbimin relevant pas datës 1 Janar, ai është i detyruar të dorëzojë në ARKEP deklaratat e kualitetit për vitin aktual para se të ketë lidhur konsumatorin e parë në rrjet.
- 6.3 Ofruesi i shërbimit universal është i obliguar t'i dorëzojë në ARKEP, jo më vonë se data 1 shkurt të çdo viti, deklaratat e kualitetit për vitin aktual për shërbimet dhe parametrat e kualitetit, të cilat nuk janë përfshirë në Obligimin për Shërbimet Universale.

Neni 7

Publikimi Deklaratave të Kualitetit të Dorëzuara nga Operatorët

- 7.1 ARKEP publikon deklaratat e dorëzuara nga operatorët në ueb faqen e saj të internetit.
- 7.2 Operatorët janë të lirë të publikojnë deklaratat e tyre në faqen e tyre të internetit duke përdorur të njëjtët formularë të referuar në paragrafin 6.1 të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Matjet e realizuara

- 8.1 Matjet e realizuara nga ARKEP;

8.1.1 ARKEP mund të kryej matje në baza të rregullta në përputhje me listën e parametrave të matur apo mund të bëjë matje në baza jo-të-rregullta ku parametrat e zgjedhur varen nga rrethanat;

8.1.2 Lista e parametrave që do të matet në baza të rregullta nga ARKEP;

- a) raporti i thirrjeve të dështuara për shërbimin telefonik në dispozicion për publikun në rrjetet publike të komunikimit fiks, në rrjetet publike të komunikimit mobil si dhe duke përdorur interkoneksionin;
- b) Koha për vendosjen e thirrjes për shërbimin telefonik në dispozicion për publikun në rrjetet publike të komunikimit fiks, në rrjetet publike të komunikimit mobil dhe duke përdorur interkoneksionin.
- c) Kualiteti i transmetimit të zërit për shërbimin telefonik në dispozicion për publikun në rrjetet publike të komunikimit fiks, në rrjetet publike të komunikimit mobil dhe duke përdorur interkoneksionin.
- d) Raporti i SMS të dërguar pa sukses në rrjetet publike të komunikimit mobil dhe duke përdorur interkoneksionin.
- e) Koha e dërgimit të SMS në rrjetet publike të komunikimit mobil dhe duke përdorur interkoneksionin.
- f) Intervali kohor për përgjigje në shërbimin e direktoriumit (numërorit) dhe shërbimin e operatorit.

8.1.3 ARKEP do të kryejë të gjitha matjet duke përdorur pajisjet e veta.

8.1.4 ARKEP do të kryejë matje në baza të rregullta në të paktën 20 vende të ndryshme në Republikën e Kosovës.

Formatted: Highlight

8.1.5 Kërkesat për llogaritjen e numrit të thirrjeve për matjen e raportit të thirrjeve të dështuara.

- a) numri i thirrjeve për matjen e raportit të thirrjeve të dështuara për shërbimin telefonik në dispozicion për publikun në rrjetet publike të komunikimit fiks dhe në rrjetet publike të komunikimit mobil duhet të llogaritet ashtu që të arrijë intervalin e besueshmërisë prej 95% dhe normën e saktësisë relative prej 10%.
- b) numri i thirrjeve për matjen raportit të thirrjeve të dështuara për shërbimin telefonik në dispozicion për publikun në rrjetet publike të komunikimit, duke përdorur interkoneksionin duhet të llogaritet ashtu që të arrijë intervalin e besueshmërisë prej 60% dhe normën e saktësisë relative prej 10%.
- c) Metodologjia e llogaritjes e përdorur është bazuar në standardin ETSI EG 202 057-2 v.1.3.1 (2009), Aneksi D.

8.1.6 Numri i SMS të dërguar që do të përdoren për matjen e kualitetit të SMS-ve gjatë një (1) viti kalendarik është 1000 SMS në çdo rrjet publik të komunikimit mobil dhe 1000 SMS ndërmjet rrjeteve publike të komunikimit mobil duke përdorur interkoneksionit në çdo drejtim.

8.1.7 Numri i thirrjeve testuese dhe shpërndarja e tyre brenda një intervali kohor me qëllim të matjes së kualitetit të shërbimit të operatorit.

Shërbimi i operatorit		
Koha	Ditët e punës (85% nga shuma totale e thirrjeve)	E shtunë dhe e diel (15% nga shuma totale e thirrjeve)
	Thirrjet (%)	Thirrjet (%)
07.00-18.00	78	80
18.00-22.00	20	20
22.00-00.00	2	-

- Numri total i thirrjeve që do të realizohen me qëllim të matjes së kualitetit të shërbimit do të përcaktohet çdo vit para datës 1 shkurt dhe kjo informatë do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të ARKEP.
- Numri total i realizimit të thirrjeve do të ndahet në mënyrë proporcionale gjatë periudhës kohore të vitit aktual.

8.1.8 Numri i thirrjeve testuese dhe shpërndarja e tyre brenda një intervali kohor me qëllim të matjes së kualitetit të shërbimit të direktoriumit publik (numërorit).

Shërbimin e Direktoriumit Publik (numërorët)		
Koha	Ditët e punës (85% nga shuma totale e thirrjeve)	E shtunë dhe e diel (15% nga shuma totale e thirrjeve)
	Thirrjet (%)	Thirrjet (%)
07.00-18.00	86	80
18.00-22.00	14	20

- Numri total i thirrjeve që do të realizohen me qëllim të matjes së kualitetit të shërbimit do të përcaktohet çdo vit para datës 1 shkurt dhe kjo informatë do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të ARKEP.
- Numri total i realizimit të thirrjeve do të ndahet në mënyrë proporcionale gjatë periudhës kohore të vitit aktual.

8.1.9 Kërkesat për matjen e kualitetit në Shërbimin e Direktoriumit Publik (numërorët) dhe shërbimin e operatorit si dhe llogaritja e rezultatit:

- a) Matjet kryhen në mënyrë manuale nga stafi (ekspertët) i autorizuar i ARKEP të cilët gjate këtyre matjeve përdorin kronometër jo-të-dëmtuara, të verifikuar si dhe të kalibruar;
- b) Eksperti do të bëjë thirrje testuese nga telefonat të lidhur me rrjetin e ofruesit të shërbimeve universale.
- c) Menjëherë pasi të jetë zgjedhur shifra e fundit e shërbimit të direktoriumit publik ose shërbimit të operatorit, eksperti fillon matjen me kronometër dhe në momentin kur dëgjon zërin e stafit, i cili lajmërohet në këto shërbime bënë ndaljen e matjes në kronometër.
- d) Rezultatet e matjeve do të shënohen në formularin përkatës, i cili është në përputhje me Aneksin 9 ose Aneksin 10 të kësaj rregulloreje;
- e) Pas përfundimit të të gjitha matjeve, eksperti llogaritë kohën mesatare të përgjigjes dhe numrin e thirrjeve që ka pasur përgjigje brenda 20 sekondave për të dy shërbimet ndaras: atë të direktoriumit publik (numërorit) dhe të shërbimit të operatorit.

8.1.10 Nëse ARKEP realizon matje të parametrave të kualitetit duke përdorur pajisjet automatike, atëherë rezultatet e matjes gjenerohen automatikisht në formularë, forma e të cilave nuk është përshkruar.

8.1.11 Operatorët kanë të drejta një (1) herë në muaj të kërkojnë dhe të pranojnë nga ARKEP informatat mbi rezultatet e matjes së parametrave të kualitetit në rrjetet e tyre.

8.2 Matjet e përmendura në listën relevante të parametrave sipas paragrafit 5.2 të kësaj rregulloreje, por që nuk ofrohen nga ARKEP sipas paragrafit 8.1.2 të kësaj Rregulloreje ofrohen nga operatorët duke përdorur të dhënat e tyre (bazën e të dhënave).

8.3 ARKEP ka të drejtë që të kontrollojë bazën e të dhënave të operatorit sa i përket kualitetit të shërbimeve.

8.4 Matjet e kryera nga ARKEP në baza të parregullta bëhen në përputhje me procedurat e përshkruara në Rregulloren e inspektimit të miratuar nga ARKEP. Me këtë rast, formularët e matjeve mund t'u bashkëngjiten nëse është e nevojshme.

Neni 9

Raportet e Kualitetit të Shërbimeve

9.1 Operatorët janë të detyruar t'i dorëzojnë në ARKEP jo më vonë se data 1 shkurt raportin e kualitetit të shërbimeve për vitin e kaluar në përputhje me formularin përkatës të përfshirë në Aneksin 6 dhe Aneksin 7 të kësaj rregulloreje.

- 9.2 Nëse operatori ka filluar të ofrojë shërbimin përkatës pas datës 1 Janar, atëherë raporti i tij i kualitetit duhet ta mbulojë periudhën e njëjtë siç është cekur në deklaratën e tij të kualitetit, e të cilën e ka dorëzuar ARKEP.
- 9.3 Ofruesi i shërbimit universal është i obliguar ta dorëzojë në ARKEP, jo më vonë se data 1 Shkurt, raportin e kualitetit për vitin paraprak për shërbimet dhe parametrat e kualitetit, të cilat nuk janë të përfshira në obligimet e shërbimeve universale.
- 9.4 Përveç kësaj, ofruesi i shërbimit universal është i obliguar ta dorëzojë në ARKEP, jo më vonë se data 1 Shkurt, raportin e kualitetit për Shërbimet Universale në përputhje me Aneksin 8 të kësaj rregulloreje.

Neni 10

Publikimi i raporteve të kualitetit të dorëzuara nga operatorët

- 10.1 ARKEP publikon raportet e kualitetit, të dorëzuara nga operatorët, në faqen e saj të internetit.
- 10.2 Operatorët janë të lirë për të publikuar raportin e tyre të kualitetit në faqen e tyre të internetit duke përdorur të njëjtën formular të referuar në paragrafit 9.1 dhe 9.4 të kësaj rregulloreje.

Neni 11

Raporti vjetor mbi kualitetin e shërbimeve i publikuar nga ARKEP

- 11.1 ARKEP një (1) herë në vit përgatit dhe publikon raportin vjetor mbi kualitetin e shërbimeve ku në mënyrë të krahasueshme janë të përfshira:
- 11.1.1 Deklaratat e operatorëve mbi kualitetin e shërbimeve;
 - 11.1.2 Obligimet mbi ofruesin e Shërbimeve Universale në lidhje me kualitetin e shërbimeve;
 - 11.1.3 Raportet e Operatorëve mbi kualitetin e shërbimeve;
 - 11.1.4 Matjet dhe llogaritjet e rezultateve të ofruara nga ARKEP;
 - 11.1.5 Komentet e ARKEP lidhur me nivelin e kualitetit të shërbimeve në Republikën e Kosovës.
- 11.2 ARKEP publikon raportin vjetor mbi kualitetin e shërbimeve jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas përfundimit të vitit.

KAPITULLI III

Shërbimi i Qasjes në Internet

Neni 12

Faqe 13 nga 40

Shërbimi që do të kontrollohet

12.1 Shërbimi i Qasjes në Internet në rrjetet publike të komunikimeve elektronike fikse dhe mobile do të kontrollohet në mënyrë të pavarur/neutral në teknologjinë e përdorur nga ofruesi i shërbimit.

Neni 13

Kualiteti i Shërbimit – Parametrat që do të maten

13.1 Çështjet e Përgjithshme:

13.1.1 Për qëllim të kësaj rregullore, grupet e shpejtësisë së bartjes së të dhënave në vijim janë përdorur:

Grupi i Shpejtësisë të Bartjes së të Dhënave	Shpejtësia minimale	Shpejtësia maksimale
Grupi 1	9.6 kbps	<256 kbps
Grupi 2	256 kbps	< 2 Mbps
Grupi 3	≥2 Mbps	< 10 Mbps
Grupi 4	≥10 Mbps	< 30 Mbps
Grupi 5	≥30 Mbps	< 100 Mbps
Grupi 6	≥ 100 Mbps	

13.1.2 ARKEP përcakton parametrat e Kualitetit të Shërbimit që do të maten për Shërbimet e Qasjes në Internet.

13.2 Lista e parametrave, të cilët do të maten/kontrollohen janë përcaktuar në tabelën në vijim:

Parametrat e kualitetit të shërbimit		
1.	Numri i defekteve	1.1. Numri i defekteve që kanë të bëjnë me një linjë të përdoruesit.
2.	Kohëzgjatja për riparimin e defektit	2.1. Numri i defekteve të shprehura në përqindje, në raport me numrin total të defekteve të pranuar nga përdoruesit, të cilat janë riparuar në afatin kohor prej tri (3) ditëve kalendarike.
		2.2. Numri i defekteve, të shprehura në përqindje, në raport me numrin total të pranuar nga përdoruesit, të cilat janë riparuar në datën e pajtuar me përdoruesin.
3.	Saktësia e faturës	3.1. Përqindja e faturave të ankimuara nga përdoruesit në raport me numrin total të faturave të dërguara tek përdoruesit.
4.	Shpejtësia e bartjes së të dhënave	4.1. Shpejtësia e bartjes së ngarkimit të të dhënave
		4.2. Shpejtësia e bartjes së shkarkimit të të dhënave
5.	Vonesa	5.1. Ngarkimi i vonuar

Parametrat e kualitetit të shërbimit		
		5.2. Shkarkim i vonuar
6.	Variacioni i vonesës	6.1. Variacion i vonuar i ngarkimit
		6.2. Variacion i vonuar i shkarkimit
7.	Shkalla e humbjes së paketës	7.1. Shkalla e Humbjes së Pakos në ngarkim
		7.2. Shkalla së Humbjes së Pakos në shkarkim
8.	Shkalla e gabimit të paketës	8.1. Shkalla e gabimit të Pakos ne ngarkim
		8.2. Shkalla e gabimit të Pakos ne shkarkim
9.	Disponueshmëria e shërbimit	9.1. Mesatarja aritmetikore nga numri i përgjithshëm i disponueshmërisë së shërbimit të rezultateve të llogaritura gjatë një cikli të pagesës.

13.3 Ofruesi i Shërbimit të Internetit vet përcakton vlerat e parametrave të Kualitetit të Shërbimit në pajtim me paragrafin 13.2 të kësaj rregulloreje.

13.4 Gjatë përcaktimit të vlerave të parametrave, Ofruesi i Shërbimit të Internetit, në pajtim me paragrafin 13.2 të kësaj rregulloreje, duhet të marrë parasysh që shpejtësia e bartjes së të dhënave, variacioni i vonesës, shkalla e humbjes se pakos dhe shkalla e gabimit të pakos duhet të matet ndërmjet pikës fundore të rrjetit dhe Njës Shkëmbyese të Internetit (KOSIX).

Neni 14

Deklaratat e Kualitetit të Shërbimit

14.1 Ofruesi i Shërbimit të Internetit është i obliguar t'i dorëzoj në ARKEP, jo me vonë se data 1 shkurt të çdo viti, deklaratën e Kualitetit të Shërbimit për shërbimet e ofruara për vitin vijues/aktual sipas formularit relevant të përfshirë në Aneksin XI të kësaj Rregulloreje.

14.2 Nëse Ofruesi i Shërbimit të Internetit fillon të ofrojë shërbim relevant pas datës 1 janar, ai është i detyruar të dorëzoj në ARKEP deklaratat e Kualitetit të Shërbimit për vitin aktual para se të ketë lidhur konsumatorin e parë në rrjet.

Neni 15

Publikimi i Deklaratave të Shërbimit të Kualitetit të dorëzuara nga Ofruesi i Shërbimit të Internetit

15.1 ARKEP publikon deklaratën e dorëzuar nga Ofruesi i Shërbimit të Internetit në ueb faqen e saj te internetit.

15.2 Ofruesi i Shërbimit të Internetit është i lirë të publikoj deklaratën e tyre në faqen e tyre të internetit duke përdorur të njëjtat forma/modele të referuar në paragrafin 14.1 të kësaj Rregulloreje.

Neni 16 **Matjet e realizuara**

16.1 Matjet realizohen nga ARKEP:

16.1.1 ARKEP mund të kryej matje në baza të rregullta për Ofruesit e Qasjes në Internet, duke ofruar shërbim në rrjetet publike të komunikimit elektronik mobil dhe fiks në pajtim me listën e parametrave në tabelën me poshtë:

1.	Shpejtësia e bartjes së të dhënave	Shpejtësia e bartjes së ngarkimit të të dhënave
		Shpejtësia e bartjes së shkarkimit të të dhënave
2.	Vonesa	Ngarkimi i vonuar
		Shkarkim i vonuar
3.	Variacioni i vonesës	Variacion i vonuar i ngarkimit
		Variacion i vonuar i shkarkimit
4.	Shkalla e humbjes së paketës	Shkalla e Humbjes së Pakos në ngarkim
		Shkalla së Humbjes së Pakos në shkarkim
5.	Shkalla e gabimit të paketës	Shkalla e gabimit të Pakos në ngarkim
		Shkalla e gabimit të Pakos në shkarkim

16.1.2 Varësisht nga rrethanat, në baza jo të rregullta ARKEP do të matë parametrat që janë të nevojshme për atë rast.

16.1.3 ARKEP do të kryej matje duke përdorur pajisjet e veta, të cilat do të jenë në dispozicion për të gjithë Ofruesit e Shërbimit të Internetit, të cilet janë të regjistruar, sipas kërkesës së tyre.

16.1.4 Pajisja fundore (modemi) i përdorur për matjet e bëra nga ARKEP duhet të merret në Qendrat e Shërbimit për Klientë të Ofrueseve të Shërbimit të Internetit. Pajisja fundore duhet të zëvendësohet me pajisje të re se paku një herë në vit para fillimit të matjeve vjetore.

- 16.1.5 Vlerat e deklaruara dhe te raportuara te Parametrave të kualitetit nga Ofruesi i Shërbimit te Internetit do te konsiderohen të vlefshme dhe merret parasysh vetëm nëse Ofruesi i Shërbimit të Internetit ka kryer matjet me pajisje plotësisht të njëjta si ARKEP.
- 16.1.6 ARKEP do të ofroj matjet në baza të rregullta për Ofruesit e Shërbimit te Internetit në rrjetet publike të komunikimeve elektronike mobile gjatë tërë vitit:
- 16.1.6.1. Do të ketë nga tre (3) deri në pesë (5) matje të marra gjatë ditëve të punës në së paku pesëdhjetë (50) vendndodhje të rastit të zgjedhura në tërë Kosovën. Vlera mesatare e rezultateve të matjes do të llogaritet për çdo Ofrues të Shërbimit të Internetit.
- 16.1.6.2. Matjet do të kryhen 24/7 në pesë qytetet më të mëdha të Kosovës. ARKEP do të vendos saktë se ku matjet do të kryhen. Vlera mesatare e rezultateve te matjes do të llogaritet për çdo lokacion për çdo Operator të Shërbimit te Internetit.
- 16.1.7 ARKEP do të ofroj matjet në baza të rregullta për Ofruesit e Shërbimit të Internetit në rrjetet publike të komunikimeve elektronike fikse në rastet ku: numri i ankesave të pranuar nga ARKEP i ndarë (pjestuar) me numrin e shfrytëzuesve fundor të Shërbimeve të Qasjes së Internetit e tejkalon vlerën 0.1%.
